

1 E martë, 3 nëntor 2023

2 [Konferencë mbi ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.31

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes. Mirë se keni
7 ardhur. Mirë se u kthyet më saktë, të paktën për disa nga
8 pjesëmarrësit këtu sot.

9 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
11 çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori i Specializuar kundër Sabit
12 Januzit dhe Ismet Bahtijarit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Ju lutem palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen, duke
15 filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes. ZPS-ja sot
18 përfaqësohet nga Nathan Quick, që është jurist, drejtues i
19 ekipit, Line Pedersen, menaxhere e lëndës dhe unë, Silvia
20 D'Ascoli, Prokurore. Faleminderit.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Prokurores.

22 I drejtohem Mbrojtjes, Mbrojtja e z. Jahuzi, ju lutem.

23 Z. REES: [Përkthim] Unë përfaqësoj z. Januzi, jam
24 Jonathan Rees, avokat. Ekipi tashmë është i formuar, jemi
25 mbledhur *tout ensemble*, në frëngjisht, jam unë Jonathan

1 Elystan Rees.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Edhe tani i drejtohem z.
3 Bahtijari. Avokat?

4 Z. SYTEMA: [Përkthim] Quhem Hendrik Sytema. Jam pjesë e
5 Dhomës së Avokatisë së Holandës, jam Avokati kujdestar i z.
6 Bahtijari.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zyra Administrative tashmë,
8 ju lutem.

9 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Zëvendës
10 Administratori dhe përfaqësoj Zyrën Administrative sot këtu,
11 z. Nilsson.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Për procesverbal, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatësi i
14 Procedurës Paraprake në këtë çështje gjyqësore.

15 Më 27 tetor, unë caktova konferencën e dytë për këtë
16 çështje gjyqësore. Qëllimi im është që të shohim si është
17 ecuria e çështjes gjyqësore, të organizojmë komunikimin mes
18 palëve në mënyrë që të organizojmë një përgatitje sa më të
19 shpejtë për gjykim.

20 Veçanërisht, dua që të diskutojmë çështjen e shqiptimit
21 të saktë të mbiemrit të z. Bahtijari si një çështje paraprake,
22 nxjerrjen e provave materiale, materialeve provuese më saktë,
23 në këtë kontekst afatet kohore për nocionet paraprake,
24 statusin e hetimeve të ZPS-së, datën e dorëzimit të dosjes
25 paraprake të ZPS-së dhe të gjitha materialeve përkatëse,

1 qëndrimin e Mbrojtjes sa i takon statusit të hetimeve të veta,
2 një synimin që kam për të dhënë njoftim për alibi ose arsye
3 për përjashtimin e përgjegjësisë, si dhe synimin e tyre për të
4 bërë kërkesë për mundësi hetimore unike dhe çdo çështje
5 tjetër, apo aspekt tjetër që palët dëshirojnë të parashtrojnë.

6 E falënderoj ZPS-në për parashtrimet që dorëzoi para
7 kësaj seance, vërej që Mbrojtja e z. Januzi dhe Mbrojtja e z.
8 Bahtijari nuk kanë dorëzuar parashtrime.

9 Sidoqoftë, si zakonisht, ftoj palët dhe Zyrën
10 Administrative që të paraqesin pikëpamjet e tyre në mënyrë
11 koncize për secilën nga pikat në rendin e ditës, që do t'i
12 trajtojmë individualisht. I kujtoj palëve dhe Zyrës
13 Administrative që do të njoftojmë paraprakisht nëse ndonjë
14 prej parashtrimeve kërkon nxjerrje të informacionit
15 konfidencial në mënyrë që të kalojmë në seancë private apo në
16 seancë të mbyllur.

17 Mirë. E fillojmë rendin e ditës me një çështje paraprake,
18 që është shqiptimi i saktë i mbiemrit të z. Bahtijari.

19 Rikujtoj se më 23 tetor, pasi u informova nga Zyra
20 Administrative se mbiemri i të akuzuarit ishte shkruar gabim
21 udhëzova Zyrën Administrative të jepte një kopje të pasaportës
22 së z. Bahtijari për këtë çështje gjyqësore, të përfshihej në
23 dokumentacionin e kësaj çështje gjyqësore.

24 Po ashtu udhëzova ZPS-në t'i përgjigjej parashtrimet të
25 protokolluar të Zyrës Administrative brenda pesë ditësh nga

1 njoftimi i sapo përmendur dhe të propozonte masa nëse ishte e
2 nevojshme.

3 Më 26 tetor, Zyra Administrative dorëzoi parashtrimin e
4 protokolluar që ka numrin 00080, me një shtojcë bashkëlidhur
5 ku ishte një kopje e pasaportës së z. Bahtijari.

6 Rikujtoj se më 31 tetor, me anë të postës elektronike
7 udhëzoza palët dhe Zyrën Administrative të përdorin mbiemrin e
8 saktë të z. Bahtijari siç është në pasaportën e tij në çdo
9 parashtrim të ardhshëm, përfshirë edhe emrin e përfshirë në
10 këtë lëndë, në lëndë gjyqësore.

11 Avokati i z. Bahtijari, keni ndonjë parashtrim në lidhje
12 me këtë?

13 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës. Nuk është e
14 nevojshme në lidhje me këtë pikë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit.

16 I drejtohem Prokurores. Znj. Prokurore, a doni të
17 dorëzoni një version të korigjuar të aktakuzës së konfirmuar
18 si në versionin rreptësisht konfidencial si dhe versionin e
19 redaktuar publik, përkatësisht janë parashtrimet e
20 protokolluara F0010, me Shtojcën 01 edhe F00016, po ashtu
21 Shtojca 1.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar. Po. Do
23 ta bëjmë këtë gjë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ka ndonjë gjë që doni të
25 shtoni në lidhje me këtë pikë?

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e morëm parasysh mbiemrin e
2 saktë të z. Bahtijari dhe do t'i korrigjojmë gabimet që kishim
3 bërë, do të dorëzojmë versione të korrigjuara sa i takon
4 pjesës së mbiemrit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. Zëvendës Administrator, keni për të thënë diçka në
7 lidhje me këtë aspekt.

8 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës. Nuk kam
9 asgjë për të thënë në lidhje me këtë.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Nilsson.

11 Flasim tani për procesin e nxjerrjes së materialeve.

12 ZPS-ja bëri me dije, në parashtrimet me shkrim, se
13 përfundoi detyrimin për nxjerrjen e materialeve në bazë të
14 rregullës 102(1)(a) më 31 tetor 2023. Vërej që paketa numër 2
15 në fakt vërtetë është nxjerrë më 31 tetor. Gjithashtu marr
16 parasysh se përmban deklaratat që janë marrë nga të akuzuarit
17 përkatësisht më 4 dhe më 5 tetor.

18 Marr parasysh që meqë ZPS-ja i ka përmbushur detyrimet
19 për nxjerrjen e materialeve në bazë të rregullës 102(1)(a) më
20 31 tetor 2023, tashmë afati për Mbrojtjen që të dorëzojë
21 mocionet paraprake fillon që atë ditë. Prandaj, në përputhej
22 me rregullën 97(2), Mbrojtja ka 30 ditë nga data për nxjerrjen
23 e materialeve që të dorëzojë mocione paraprake, që i bie deri
24 më 30 tetor 2023.

25 Pas kësaj, ZPS-ja ka dhjetë ditë për t'u përgjigjur dhe

1 më pas Mbrojtja ka pesë ditë për t'u kundërpërgjigjur në bazë
2 të rregullave 9 dhe 76.

3 Vërej në këtë kontekst se afati për Mbrojtjen e z. Januzi
4 dhe Mbrojtjen e z. Bahtijari i bie gjatë pushimit të Gjykatës
5 që fillon të hënën më 18 tetor [sipas përkthimit]. Prandaj,
6 sikurse kam bërë edhe në rastet e mëhershme, synoj që të
7 modifikoj kalendarin për dorëzimin apo afatet për dorëzimin e
8 dosjeve, në mënyrë që të përgatiten kundërpërgjigjet.

9 Përpara se të vijoj, ftoj ZPS-në dhe ekipet e Mbrojtjes
10 të bëjnë parashtrime me gojë në lidhje me këtë temë, duke
11 filluar me Prokuroren.

12 Znj. Prokurore, fjala është për ju.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, e marrim
14 parasysh ndryshimin e afateve, nuk kemi asnjë koment për të
15 thënë në lidhje me këtë. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
17 Prokurore.

18 Mbrojtja e z. Januzi.

19 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, sikurse e dini,
20 vetëm së fundmi jemi udhëzuar, se tani e kemi marrë qasjen në
21 dosje, vetëm dje e kemi parë dosjen. Në këtë pikë kohore, ne
22 synojmë të ndjekim rregullin 30 ditor për parashtrimin e
23 mocioneve paraprake. Në qoftë se do të kem ndonjë problem me
24 këtë datë, do kërkojmë në kohë shtyrjen e afatit siç e
25 parashikon rregullorja.

1 Supozoj se ne do jemi në gjendje që të respektojmë afatin
2 aktual, por sidoqoftë do kërkonim që ju i nderuar Gjykatës të
3 jepni kohë të kundërpërgjigjemi lidhur me përgjigjet e
4 Prokurorisë. Jemi në duart tuaja nëse do jepni këtë mundësi
5 që të kemi mundësi të kundërpërgjigjemi pas pushimit të
6 Gjykatës.

7 Nuk kam ndonjë gjë më shumë për të thënë në lidhje me
8 këtë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Avokat.
10 Mbrojtja e z. Bahtijari.

11 Z. SYTEMA: [Përkthim] Nuk kam asnjë koment në lidhje me
12 këtë temë për momentin. Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.
14 Më jepni një çast.

15 Do nxjerr një urdhër me gojë në lidhje me këtë temë po në
16 fund të konferencës për ecurinë e çështjes gjyqësore.

17 Vërej, që ZPS-ja bëri me dije, në parashtrimin me shkrim,
18 se nuk ka asnjë vështirësi sa i takon nxjerrjes së materialit
19 provues në këtë moment në kohë dhe se ka marrë parasysh
20 kalendarin që është përcaktuar në vendimin kornizë mbi
21 nxjerrjen e provave dhe çështjeve në lidhje me to që është i
22 datës 24 tetor 2023.

23 Gjegjësisht, ZPS-ja ka specifikuar se është ende duke
24 rishikuar materialet e rregullës 103 dhe po ndjek të gjitha
25 hapat e nevojshëm sa i takon redaktimeve dhe në vijim të

1 këtyre hapave, do t'i nxjerrë menjëherë materiale të tilla.

2 Më tej ZPS-ja specifikon që synon të marrë prova shtesë
3 që janë material i rregullës 102(1)(b) dhe përkthimet
4 përkatëse pritet që të përfundohen brenda afatit të propozuar
5 për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b).

6 Znj. Prokurore, keni ndonjë parashtrim në lidhje me këtë
7 temë?

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të
9 thënë. I qëndrojmë parashtrimeve që kemi dorëzuar dhe nuk kemi
10 gjë për të shtuar.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I drejtohem Mbrojtjes.

12 Avokat, keni ndonjë parashtrim lidhur me nxjerrjen e
13 materialeve? Z. Rees?

14 Z. REES: [Përkthim] Jo, jo. Sa i takon afatit që është
15 propozuar, po dua të ngre një aspekt që është "çështje tjetër"
16 në rendin e ditë dhe do ta ngre këtë në momentin e duhur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Sytema?

19 Z. SYTEMA: [Përkthim] Nuk kam asnjë koment në lidhje me
20 këtë temë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

22 Së fundi, sa i takon po ashtu nxjerrjes së materialeve,
23 vërej se ZPS-ja ka propozuar në parashtrimet me shkrim
24 nënkategorizimin sipas provave dhe kjo duhet të bëhet në *Legal*
25 *Workflow*.

1 Znj. Prokurore, a arritët të diskutoni *inter partes* dhe
2 a patët dakordësi me Mbrojtjen në lidhje me këtë temë?

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, ju konfirmoj këtë gjë që
4 bashkë me avokatët kemi komunikuar më 1 nëntor, Mbrojtja e z.
5 Bahtijari u përgjigj propozimit tonë dhe u pajtua me të sa i
6 takon kategorive dhe nënkategorive që duhet të kemi në *Legal*
7 *Workflow*. Edhe sot në mëngjes edhe z. Rees tha që nuk kishte
8 asnjë kundërshtim me këtë dhe nuk ka asnjë kundërshtim sa i
9 takon propozimit.

10 Prandaj mund ta konsideroni që kemi pasur marrëveshje me
11 njëri-tjetrin dhe mund të zbatojmë kategoritë dhe
12 nënkategoritë në *Legal Workflow*. Pra, jemi në duart tuaja sa i
13 takon miratimit të kësaj kërkesë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.
15 Prokurore.

16 I drejtohem Mbrojtjes.

17 Z. Rees.

18 Z. REES: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të thënë në lidhje
19 me këtë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, pajtoheni me
21 kategorizimin e propozuar?

22 Z. REES: [Përkthim] Po, pajtohem.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

24 Z. SYTEMA: [Përkthim] Po, edhe Mbrojtja nga ana jonë
25 pajtohet sikurse tha edhe ZPS-ja. Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Vërej që është gjetur një marrëveshje mes palëve dhe do
3 të nxjerrë urdhrin e parë me gojë.

4 Urdhëroj miratimin e kategorizimit dhe nënkategorizimit
5 në mënyrë specifike sipas provave në *Legal Workflow* sikurse
6 është propozuar nga ZPS-ja në paragrafin 9 të parashtrimeve me
7 shkrim që mbajnë datën 31 tetor 2023, me numër F00084.

8 Me këtë mbyll urdhrin e parë me gojë.

9 Kalojmë tek pika e tretë në rendin e ditës, që është
10 statusi i hetimeve të ZPS-së.

11 Në parashtrimet me shkrim, ZPS-ja bëri me dije që ka ende
12 hapa hetimorë në vazhdim e sipër, po bëhet analiza dhe më pas
13 do të bëhet nxjerrja e materialeve sipas rastit.

14 Më tej bëri me dije se është e mundshme që mund të ketë
15 hapa të mëtejshëm hetimorë në vijim të analizës dhe ZPS-ja
16 është duke organizuar punën për t'i ndërmarrë këto hapa brenda
17 fundit të dhjetorit të 2023 për aq sa është e mundur.

18 Znj. Prokurore, a doni të shtoni ndonjë gjë veç
19 parashtrimeve me shkrim? Tani shoh që u çua z. Prokuror.

20 Z. QUICK: [Përkthim] Ishte një përmbledhje shumë e mirë
21 ajo që bëtë, nuk kam asgjë për të shtuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

23 I drejtohem Mbrojtjes. Keni ndonjë gjë parashtrim sa i
24 takon hetimit të ZPS-së?

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] Jo.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

3 Z. SYTEMA: [Përkthim] Nuk kemi asnjë parashtrim.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

5 Kalojmë te dosja paragjyqësore e ZPS-së dhe materialet në
6 lidhje me të.

7 Në parashtrimet me shkrim ZPS-ja bëri me dije se në
8 kuadër të kalendarit që është përcaktuar në vendimin kornizë,
9 parashikon që do të jetë në gjendje të dorëzojë dosjen
10 paraprake dhe materialet në lidhje me të brenda të premtës, 2
11 shkurt 2024.

12 Zonja apo zoti Prokuror, doni të shtoni ndonjë gjë në
13 lidhje me këtë aspekt? Z. Prokuror.

14 Z. QUICK: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të shtuar,
15 por në qoftë se ka pyetje unë do t'u përgjigjem me kënaqësi.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Konfirmoni datën?

17 Z. QUICK: [Përkthim] Po, konfirmojmë të njëjtën datë,
18 është 2 shkurt 2024.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I drejtohem Mbrojtjes.

20 Z. Rees, keni ndonjë koment në lidhje me afatet?

21 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk kam koment për propozimin që
22 ka bërë ZPS-ja për dosjen paraprake më 2 shkurt. Kjo nuk
23 dikton, sigurisht, kohën për -- kjo dikton, kjo është, në
24 varësi të kësaj do bëhet dorëzimi i dosjes paraprake nga
25 Mbrojtja.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

2 Z. SYTEMA: [Përkthim] Nuk kemi asnjë koment në lidhje me
3 këtë temë. Faleminderit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit, Avokat.

5 Pasi dëgjova palët, do të nxjerrë një urdhër të dytë me
6 gojë sa i takon dorëzimit të dosjes paraprake nga ana e ZPS-
7 së.

8 Urdhëroj ZPS-në të dorëzojë dosjen paraprake sipas
9 kuptimit të rregullës 95(4)(a) të Rregullores brenda të
10 premtës, 2 shkurt 2024 dhe jo më vonë se kjo datë.

11 Me këtë mbyll urdhrin e dytë me gojë.

12 Për pikën tjetër në rendin e ditës, fillimisht do t'i
13 drejtohem Mbrojtjes.

14 Vërej që Mbrojtja nuk ka dorëzuar asnjë parashtrim me
15 shkrim para kësaj konference për ecurinë e çështjes gjyqësore.
16 Sidoqoftë, bazuar në informacionin që ka dhënë Prokuroria në
17 përgatitje të kësaj konference për ecurinë e çështjes, dua
18 t'ju pyes, a jeni në pozicion të jepni parashtrim paraprak
19 fillimisht sa i takon statusit të hetimeve tuaja, së dyti,
20 synimit tuaj për të njoftuar për alibi apo arsye për
21 përjashtim përgjegjësie apo nxjerrje e materialeve përkatëse
22 dhe, së treti, a synoni të bëni kërkesa për mundësi hetimore
23 unike.

24 Dhe filloj me Mbrojtjen e z. Januzi.

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] Sikurse ju thashë, i nderuar
2 Gjykatës, ne vetëm dje kemi marrë informacionin, kështu që nuk
3 jemi në gjendje që t'ju përgjigjemi në lidhje me këto tre
4 tema. Ka një çështje konkrete sa i takon përgatitjes për këtë
5 çështje gjyqësore që dua ta trajtojmë, po dua që ta diskutojmë
6 te pika e fundit në rendin e ditës dhe dua të flasim edhe për
7 afatet kohore për çështjen e ndalimit dhe lirimit të
8 përkohshëm, e cila është ende në pritje e sipër për përgjigje.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Sytema.

10 Z. SYTEMA: [Përkthim] Faleminderit. Mbrojtja nuk ka
11 parashtrime konkrete në këtë moment. Ne këtë javë morëm disa
12 materiale provuese. Duhet ta diskutojmë me z. Bahtijari dhe
13 vetëm pasi të diskutojmë me z. Bahtijari, mund të jetë momenti
14 i duhur që unë mund të bëjë parashtrime. Por ama nuk mund të
15 them asgjë për momentin.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Sytema.

17 Në qoftë se keni ndonjë, diskutoni ndonjë prej këtyre
18 çështjeve në fazën paraprake, unë si zakonisht e ftoj
19 Mbrojtjen që aspektet apo çështjet që duan të ngrenë ta bëjnë
20 sa më shpejtë në një mënyrë që mos ta vonojmë çështjen
21 gjyqësore.

22 Zonja apo zoti Prokuror, a keni ju gjë për të thënë në
23 lidhje me këtë?

24 Z. QUICK: [Përkthim] Jo, asgjë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

1 Dëshiroj tani t'u kërkoj palëve dhe Zyrës Administrative
2 nëse kanë ndonjë çështje tjetër që duan të parashtrojnë dhe
3 kujtoj palët dhe Zyrën Administrative nëse kanë ndonjë
4 parashtrim që kërkon nxjerrje të informacionit konfidencial,
5 të lutem, të na bëjnë me dije përpara se të marrin fjalën në
6 mënyrë që të kalojmë në seancë të mbyllur apo private në se
7 është e nevojshme.

8 I drejtohem Prokurores.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Asgjë prej nesh.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees, ju thatë që donit
11 të thoshit diçka?

12 Z. REES: [Përkthim] Kam dy gjëra që dua të diskutoj.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Duhet të kalojmë në seancë
14 private?

15 Z. REES: [Përkthim] Po, do kalojmë në seancë private, po
16 të diskutoj aspektin e parë fillimisht sepse këtë mund ta
17 bëjmë në seancë publike.

18 Aspekti i parë është afati që i keni caktuar ju, i
19 nderuar Gjykatës, sa i takon aspektit të ndalimit apo lirimit
20 të përkohshëm.

21 Ne jemi në dijeni që keni përcaktuar disa afate kohore
22 për të dhënë mundësinë e një parashtrimi që është në vijim të
23 një kërkesë që është bërë për lirim të përkohshëm. Ju
24 kërkojmë, i nderuar Gjykatës, që ta rishikoni edhe një herë
25 afatin, që të na jepni mundësinë që fillimisht të njihemi me

1 dosjen gjyqësore, më pas të shohim kërkesat që janë dorëzuar
2 deri tani sa i takon ndalimit, paraburgimit dhe lirimit të
3 përkohshëm dhe, në qoftë se është nevoja të bëjmë ndonjë
4 ndryshim dhe t'i ridorëzojmë.

5 Kjo është kërkesa ime e parë, pra, të ndryshoni afatin
6 kohor që të na jepni mundësinë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Para se të kaloni tek tema
8 e dytë që doni të diskutoni, a mund të më jepni një propozim
9 çfarë afatesh dëshironi ju, çfarë afatesh dëshironi që të
10 keni?

11 Z. REES: [Përkthim] Të paktën shtatë ditë të rishikojmë
12 kërkesat që janë dorëzuar deri tani dhe, nëse është nevoja, të
13 bëjmë një kërkesë të rishikuar për lirim të përkohshëm.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, një javë që sot?

15 Z. REES: [Përkthim] Po.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Para se të kalojmë tek pika
17 e dytë, do kaloj, do i drejtohem ZPS-së në mënyrë që të
18 përfundojmë me këtë çështje.

19 Z. Prokuror.

20 Z. QUICK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, sa i takon
21 kërkesës së z. Rees, e lëmë në dorën tuaj, i nderuar Gjykatës.
22 Afati për t'ju përgjigjur ishte sot, ne jemi gati nga ana jonë
23 që të vijojmë.

24 Sa i takon këtij të akuzuari, ne jemi dakord që të
25 shtyhet afati. Ndërsa për të akuzuarin tjetër mendojmë që

1 afati duhet të qëndrojë siç ka qenë fillimisht.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I drejtohem, z. Sytema sa i
3 takon parashtrimin të Prokurorisë që afati të qëndrojë siç
4 është për klientin tuaj. Keni ndonjë parashtrim, apo edhe ju
5 keni kërkesë që të ndryshohet afati për parashtrimet tuaja?

6 Z. SYTEMA: [Përkthim] Nga ana ime nuk ka nevojë për
7 ndryshim afati, megjithatë ky është vendim i juaji. Mbase do
8 ishte mirë që për të dyja ekipet e Mbrojtjes afatet të jenë
9 njësoj. Po ama nuk është nevoja që ta ndryshojmë nga ana ime,
10 sidoqoftë unë do respektoj ndryshimet që do të bëni ju në këtë
11 drejtim.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

13 Z. Rees, doni të kundërpërgjigjeni?

14 Z. REES: [Përkthim] Jo, faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

16 Do nxjerr një urdhër me gojë në fund të konferencës për
17 ecurinë e çështjes gjyqësore sepse do të bëjmë një pushim të
18 shkurtër.

19 Tani mund të kalojmë tek pika e dytë, z. Rees. A është
20 nevoja të kalojmë në seancë private?

21 Z. REES: [Përkthim] Po, ju lutem.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Sekretare e Gjykatës,
23 të kalojmë në seancë private dhe më njoftoni pasi ta keni
24 përfunduar këtë.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Mbani shënim se z. Sytema dhe Zyra Administrative nuk

16 kanë parashtrime të mëtejshme për këtë konferencë për ecurinë

17 e çështjes.

18 Tani dua t'i informoj palët dhe Zyrën Administrative se

19 konferencën e tretë për ecurinë e çështjes dua mbajmë në 14

20 dhjetor, të enjten, pra, dhjetor 2023.

21 Në këtë drejtim kujtoj se nëse Mbrojtësi apo të akuzuarit

22 dëshirojnë të marrin pjesë përmes videokonferencës, duhet t'a

23 njoftojnë me shkrim Zyrën Administrative 24 orë më përpara me

24 qëllim që të merren masat e nevojshme. Një njoftim i tillë

25 duhet të përfshijë pëlqimin me shkrim të akuzuarit siç bëri

1 Mbrojtja në rastin e kësaj konference.

2 Dhe zakonisht do të marrim një urdhër që do të përfshijë
3 -- do të merrni një urdhër që përfshin programin. I ftoj palët
4 të bëjnë parashtrime me shkrim nëse kanë dëshirë të ngrenë
5 ndonjë çështje konkrete gjatë konferencës tjetër.

6 Do të bëjmë një pushim përafërsisht 20 minuta dhe do të
7 kthehemi dhe unë do të jap urdhrin me gojë përpara se ta
8 mbyllim këtë konferencë. Për momentin kemi 20 minuta pushim.

9 --- Pauza fillon në orën 10.03

10 --- Seanca rifillon në orën 10.22

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në lidhje me mocionet
12 paraprake dhe përgjigjet dhe kundërpërgjigjet po nxjerr këtë
13 urdhër.

14 Pasi dëgjova palët, e gjej me vend që të ndryshoj afatet
15 e parashikuara në Rregullore. Kështu që e urdhëroj Mbrojtjen e
16 z. Januzi dhe Mbrojtjen e z. Bahtijari t'i kundërpërgjigjen
17 përgjigjes së ZPS-së për çdo mocion paraprak deri në 9 janar,
18 të martë, 2024.

19 Këtu përfundon urdhri im i tretë gojor.

20 Tani do të nxjerrë urdhrin e katërt.

21 Pasi dëgjova palët dhe duke marrë parasysh caktimin e një
22 mbrojtësi të ri për z. Januzi, e gjej të përshtatshme të
23 ndryshoj afatin e parashikuar në rregullore lidhur me çdo
24 parashtrim shtesë nga Mbrojtja e z. Januzi në lidhje me
25 lirimin e përkohshëm dhe përgjigjen e ZPS-së ndaj këtyre

1 parashtrimeve plotësuese.

2 Kështu që e urdhëroj Mbrojtjen e z. Januzi të dorëzojë
3 parashtrimet shtesë deri në 10 nëntor, ZPS-në të përgjigjet
4 deri në 17 nëntor dhe Mbrojtjen e z. Januzi të
5 kundërpërgjigjet deri në 24 nëntor.

6 Këtu përfundon dhe urdhri im i katërt gojor.

7 Afati për parashtrime lidhur me kërkesën për lirim të
8 përkohshëm nga z. Bahtijari mbetet e njëjtë.

9 Këtu përfundon seanca e sotme. Si gjithmonë, falënderoj
10 palët, Zyrën Administrative për pjesëmarrjen dhe stenografin,
11 teknikët dhe përkthyesit dhe personelin e sigurisë për ndihmën
12 e tyre.

13 Këtu përfundon kjo seancë.

14 --- Konferenca për ecurinë e çështjes mbyllet
15 në orën 10.25

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25